

HIDROKOL TË BARDHË

Ngjitës një-komponentësh për pllaka, i prodhuar në bazë çimentoje
Përgjigjet EN 12004-1, klasi C1

FUSHA E APLIKIMIT

Për ngjitje të pllakave qeramike për mure, për përdorim të brendshëm: holle, hapësire për të jetuar, hapësira afariste dhe ngjashëm.

CILËSI

- ngjitshmëri e mirë;
- adezion i shkëlqyer;
- përgatitje e thjeshtë;
- aplikim i thjeshtë;
- kohë e zgjatur e hapur për punë ekonomik.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSI	METODË	VLERË E DEKLARUAR
Dukje	-	të bardhë
Klasi	EN 12004	C1
W/M faktor ujë/material	-	0,22-0,26
Kohë e hapur për ngjitje në temperaturë prej 20°C	EN 1346	20min
Kohë e hapur për përpunim në temperaturë prej 20°C	-	4-5h
Adezion për nënshtresën gjatë kushteve normale	EN 1348	>0,5MPa
Adezion për nënshtresën pas zhytjes në ujë	EN 1348	>0,5MPa
Adezion për nënshtresën pas ciklit të ngrirjes/shkrirjes	EN 1348	>0,5MPa
Fillimi i lidhjes	-	5-8h
Fundi i lidhjes	-	12h

METODOLOGJIA E VENDOSJES

PËRGATITJE E NËNSHTRESËS

Hidrokol të bardhë vëhet në nënshtresë të shëndoshë të betonit, suva çimentoje ose të zgjatur. Nënshtresa duhet të jetë e pastër, pa pluhur dhe e lagur mirë me ujë.

VENDOSJE

Hidrokolli të bardhë përgatitet duke shtuar 5-7l ujë të pastër në një qese 25kg, me ç'rast masa përzihet vazhdimisht deri në homogjenizimin e plotë. Pas përzierjes, duhet të lihet të rri më së shumti 10 minuta, pas së cilës përzihet sërish dhe aplikohet.

Vendosja është me glet-vegël të dhëmbëzuar ose me shpahëll në shtresë prej 4 – 10 mm, në tërë sipërfaqen e nënshtresës ku duhet të ngjiten pllakat.

Per aplikim uniform te ngjitesit ne bazament, rekomandohet qe te aplikohet nje shtrese e holle duke perdorur anen e rrafshet te malles dhe menjehere, aplikoni ngjitesin duke perdorur anen e dhembezuar te malles.

Para instalimit pllakat duhet të vendosen në ujë dhe Kohë e hapur për vënie të materialit të përzier është 20 minuta, në temperaturë prej 20°C. Gjate aplikimit, ne rast se sipërfaqja fillon të ngurtesohet, është e nevojshme që të riperzihet me mistri që të aktivizohen karakteristikat ngjitesë të llacit. Nëse masa e përgatitur ngurtesohet, nuk rekomandohet të shtohet uje në të për të parandaluar uljen e aftësisë ngjitesë të produktit. Temperatura e nënshtresës gjatë vendosjes duhet të jetë midis 5°C deri 35°C. Shtresat midis pllakave duhet të përpunohet me përzierje për fugim Fugofill, më herët 24 orë pas vendosjes.

SHPENZIMI

Për shtresë me trashësi prej 1 mm ~1,1 kg/m²
varësisht nga nënshtresa ~3,3-6,6kg/m²

PASTRIMI

Mjetet dhe pajisjet pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

PAKETIMI

Ventil thasë: 25kg

VENDOSJE NË DEPO

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të mbyllura në temperaturë prej 5°C deri +35°C. Afati i përdorimit 12 muaj.

Rrezik për jetën: Nevojitet që të shmangët kontakti i prodhimit me lëkurën, si dhe thithje e drejtpërdrejtë të pluhurit. Gjatë kontaktit me prodhimin, menjëherë duhet të mënjanohet me sapun dhe ujë. Nëse materiali rastësisht vjen në kontakt me sytë, menjëherë duhet të shpëlahet me ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gëlltitet, nevojitet së menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: : Prodhimi nuk mund të ndizet.

Pastrimi dhe deponimi: Pastrimi është me ujë. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullatave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.